

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Zonja Kryetare,

Së pari, për procedurë, kërkesa të tilla, që ju i fusni befas në seancë, besoj se nuk ju bëjnë nder as juve dhe as Rregullores. Rendi i ditës, i nxjerrë jo nga ju, por nga ajo që kishit lënë si mëkëmbëse, nuk e përmbante këtë pikë të rendit të ditës. Ju vendosët të fusnit sot në mënyrë të befasishme një çështje që nuk është pa rëndësi, por është ndoshta nga çështjet më të rëndësishme. Bëhet fjalë për një nga të drejtat themelore të opozitës, komisionin hetimor; bëhet fjalë për një nga çështjet më delikate, investimet strategjike, dhe ju në mënyrë të befasishme doni ta kaloni shpejt e shpejt, si pa ndodhur asgjë.

Sipas Rregullores, ai vendim do të duhet të debatohet dhe do të duhet të diskutohet brenda një afati 15-ditor, nga momenti kur Konferenca e Kryetarëve e ka marrë atë vendim, siç e cituat ju. Për këtë arsye në rendin e ditës të dalë dje, nga ajo që ju latë për të drejtuar parlamentin, kjo nuk ishte. Kërkesa ime është që kjo çështje të meritojë dhe të ketë kohën e duhur për t'u diskutuar nga seanca plenare dhe nga të gjithë deputetët. Kalimi në mënyrë të fshehtë, shpejt e shpejt, nuk ju bën nder as juve dhe nuk i bën nder as këtij parlamenti.

Zonjë, ju e para, jeni e lutur ta respektoni Rregulloren e parlamentit!